




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit: N.SH. "KLINET"

Pronar: Rrahim HASANI

Operatori i Shpërndarjes: N.SH. KLINET

Adresa: Sheshi Mujë Krasniqi, p.n. Klinë



VENDIM

për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes N.SH. KLINET, me seli në Klinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. N.SH. KLINET është operatorë i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregulloren KPM-2020/01, me seli në Klinë. KPM, me datën 26 maj 2015, ka marr vendim për dhënien e licencës për Operatorin e Shpërndarjes N.SH. KLINET.
3. Më datën 25 tetor 2021, pronari i operatorit të shpërndarjes N.SH. KLINET, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar se heqë dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes.


Arsyetimi

4. Duke u bazuar në njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes N.SH. KLINET, për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, Komisioni vlerëson se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së operatorit të shpërndarjes N.SH. KLINET.
5. Komisioni konstaton se Operatori i Shpërndarjes N.SH. KLINET ka shlyer të gjitha detyrimet financiar ndaj KPM-së.

Vendim

6. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 9 nëntor 2021, merr vendim për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes N.SH. KLINET, me seli në Klinë, sipas njoftimit për heqje dorë, në mënyrë vullnetare, nga Licenca e KPM-së.

7. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



22.11.2021

datë